



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

**PËR TESTIMIN E ADMINISTRATORËVE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE
TË FONDEVE TE PENSIONEVE**

Miratuar me vendim Bordit nr .113, datë 18.11.2010

Ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 152, datë 30.11.2017

**Neni 1
Objekti**

Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e procedurave të organizimit të testimit të administratorëve të shoqërisë administruese të fondeve të pensioneve, ngritjen e komisionit të testimit, si dhe rastet e delegimit të organizimit të testimit në qendra specializuara ose universitete/fakultete.

**Neni 2
Baza Ligjore**

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe nenit 24 dhe 25 të ligjit nr.10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”.

**Neni 3
Të përgjithshme**

1. Administratorët e shoqërisë administruese të fondeve të pensioneve i nënshtrohen testimit për njohuritë mbi legjislacionin dhe fushën e administrimit të fondeve të pensioneve.
2. Testimit i nënshtrohen vetëm ata administratorë që plotësojnë kërkesat e nenit 24 dhe 25, të ligjit nr.10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”,

**Neni 4
Mënyra e organizimit të testimit**

Testimi mund të organizohet nga:

1. Qendra të specializuara për organizimin e trajnimeve dhe testimeve për administratorë risku, administratorë portofolesh, administratorë investimesh financiare.
2. Universitete/Fakultete me profil ekonomist për financë - bankë
3. Komisioni “ad hoc” i krijuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së.

Neni 5

Koha e organizimit të testimit

1. Departamenti i Mbikqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria administruuese e fondeve të pensioneve për kandidatët në postin e administratorit të shoqërisë, i paraqet Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së, listën e personave që do t'i nënshtrohen testimit.
2. Me paraqitjen e listës, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së me propozim të Departamentit të Mbikqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, vendos për mënyrën e organizimit të testimit sipas nenit 2, të kësaj rregulloreje.
3. Kandidatet për testim njoftohen një javë para zhvillimit të testimit.

Neni 6

Komisioni “ad hoc” i testimit

1. Komisioni “ad hoc” përbëhet nga 5(pesë) anëtarë, punonjës të AMF-së si dhe profesionistë të fushës jashtë AMF-së.
2. Përbërja e komisionit të testimit dhe raporti midis punonjësve të AMF-së dhe profesionistëve të jashtëm caktohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së, sipas propozimit të Departamentit të Mbikqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve.
3. Komisioni i Testimit është përgjegjës për procedurën e testimit, ku përfshihet organizimi i testimit, hartimi i pyetjeve, korrigjimi i testeve dhe nxjerrja e rezultateve.

Neni 7

Delegimi i testimit në Qendra të specializuara/universitete/fakultete

Në rastet kur testimi kryhet nga një Qendër e specializuar apo një universitet/fakultet, sipas urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së, organizimi i testimit dhe nxjerrja e rezultateve është përgjegjësi e entit të përzgjedhur.

Neni 8

Procedura e testimit

1. Në testim kandidati duhet të jetë i pajisur me një dokument identifikimi.

2. Komisioni i Testimit vë në dispozicion të kandidatëve materialet për zhvillimin e testimit.
3. Fletët me përgjigjet e testimit duhet të vulosen të gjitha me vulën e AMF-së.
4. Në përfundim të testimit, të gjitha fletët sekretohen nga Kryetari i Komisionit të Testimit dhe korrigjohen në ambientet e godinës së AMF-së.

Neni 9

Testi

1. Totali i pikëve të tezës është 100 pikë, pikët minimale për kalimin e testit janë 55.
2. Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga data e zhvillimit të testimit shpall rezultate e testimit në faqen zyrtare të tij.

Neni 10

Përsëritja e testimit

Subjektet e përcaktuara në nenin 1, pika 1, të kësaj Rregulloreje, nëse marrin vlerësim negativ në testim, kanë të drejtën e përsëritjes së provimit, por jo më parë se 3(tre) muaj nga data e testimit të parë.

Neni 11

Fusha e testimit

Testimi do të përfshijë njohuri nga:

- a. Aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e pensioneve vullnetare.
- b. Teoria e portofolit.
- c. Menaxhimi i riskut në investime.
- d. Njohuri të tjera në lidhje me fushën e pensioneve vullnetare.

Neni 12

Dispozita të fundit

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Elisabeta Gjoni

Kryetar

U D H Ë Z I M

Për përshtatshmërinë dhe aftësinë e administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit të Administrimit

Në mbështetje të nenit 14 pika 6/l të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

U d h ë z o n

1. Çdo administrator dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit të administrimit të Shoqërisë administruese të fondit të pensionit duhet të kenë:

- a) kualifikim të përshtatshëm universitar që do të thotë se duhet të ketë një diplomë të nivelit universitar, me të paktën 4 vite studimi.
- b) kualifikim profesional të përshtatshëm, kapacitet dhe eksperiencë të nevojshme për menaxhimin e aktivitetit të administrimit të fondeve.

2. Kualifikimet profesionale të përshtatshme nënkuptojnë pajisjen me certifikata dhe diploma që vërtetojnë përfundimin e shkollave, kurseve dhe trajnimeve në fushën e administrimit të fondeve. Këtu mund të konsiderohen:

- a) licencë e fituar nga një autoritet rregullator brenda apo jashtë vendit për administrimin e fondeve të pensionit
- b) certifikatë për menaxhim fondesh dhe portofolesh,
- c) certifikatë për menaxhim risku,
- d) CFA

3. Eksperienca profesionale nënkupton të paktën 5 vjet eksperiencë në pozicione drejtuese në aktivitete, të cilat mund të krahasohen me biznesin e Shoqërisë administruese të fondit të pensionit. Këtu do të vlerësohet eksperienca në pozicione drejtuese në shoqëri që operojnë në sektorin financiar, pozicione të cilat lidhen me menaxhimin e portofoleve, menaxhimin e riskut

4. . Reputacion të mirë, që nënkupton:

- a) aftësi biznesi,

- b) nuk ka drejtuar biznese që kanë shkuar drejt falimentimit dhe likuidimit,
- c) nuk i është hequr licenca personale apo e biznesit që drejton nga autoritetet rregullatore për shkak të mos plotësimit të rregullave
- d) nuk është dënuar për akte kriminale

5. Administratorët e shoqërisë duhet të jenë të punësuar me kohë të plotë te shoqëria e administrimit të fondit të pensionit.

6. Administratorët e shoqërisë duhet t'i nënshtrohen testimit për njohuritë profesionale dhe të legjislacionin në fushën e administrimit të fondeve të pensioneve. Organizimi i testimit do të kryhet sipas rregullores përkatëse.